



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 581 Prot

Tiranë, më 28.01. 2019

UDHËZIM

Nr. 43 Datë 28.01. 2019

PËR
NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 493, DATË 13.11.2017 "PËR ADMINISTRIMIN E
PROCEDURAVE TË PUNËSIMIT PËR PROFESIONET E SHKENCAVE MJEKËSORE
TEKNIKE NË INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 dhe të nenit 199 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 812, datë 26.12.2018 "Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore jashtë shërbimit civil, për vitin 2019",

UDHËZOJ:

1. Pas pikës 4 të kreu 2 "Konkurimi me dosje" të udhëzimit nr. 493, datë 13.11.2017 shtohet pika 4/1 me përmbajtjen si më poshtë:
 - a) Për vitin 2019, të gjithë studentët e ekselencës të diplomuar duke filluar nga viti 2017 e në vijim në profilet e shkencave mjekësore teknike, që aplikojnë në portalin "Infermier për Shqipërinë", marrin një bonus 10 pikë shtesë në llogaritjen e pikëve totale.
 - b) "Studentë të ekselencës", janë studentët të cilët kanë përfunduar studime universitare në secilin prej cikleve të arsimit të lartë me mesatare 9.00 – 10 ose ekuivalent.

MINISTËR

Ogerta Manastirliu